

## Lëshimi i vërtetimeve

### Përshkrimi

Përpilimi i vërtetime të ndryshme për t'u përdorur në rrethin e juridiksionit.

### Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Një dokument identifikimi si pasaportë ose kartë identiteti biometrike
- 2) Dokumente të tjera mbështetëse me të cilat të justifikojë mjaftueshëm nevojën për lëshimin e vërtetimit;

### Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personalisht e të interesuarit para konsullit ku bëhet verifikimi i identitetit të tij.
- 2) Dorëzimi i mandat-pagesës origjinale të tarifës, që ka derdhur në numrin e llogarisë së përfaqësisë diplomatike ose konsullore të RSH
- 3) Konsulli përpilon vërtetimin në dy kopje origjinale;
- 4) Leximi i vërtetimit nga personi i interesuar kur lëshohet vërtetimi;
- 5) Një vërtetim i dorëzohet personit të interesuar;
- 6) Vërtetimi tjetër mbahet në arkivin e ambasadës apo konsullatës së bashku me fotokopjen e vërtetimit që i është dorëzuar të interesuarit, i cili ka pullën e taksës, si dhe dokumentet mbështetëse të njësuara me origjinalin nga konsulli.

### Tarifa e shërbimit dhe afati

30 euro ose shuma ekuivalente në monedhën vendase.

Vërtetimi përpilohet në momentin që paraqitet i interesuari.

### Zyra

Të gjithë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

### Shënime

Vërtetimet mund të lëshohen në gjuhën e vendit pritës si dhe në një gjuhë tjetër të njohur ndërkombëtarisht.

Në rastet kur konsulli nuk është i bindur për vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga shtetasi, ai kryen procedurat e verifikimit të tyre nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme